

Data 25.09.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

Mirëmbajtje e Sistemeve të Parkimit

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mirëmbajtje dhe Riparim i Makinerisë për dhënien e Biletave **50316000-3**
Shërbimet e Parkimit **98351100-9**

VLERA E FONDIT LIMIT:

2,400,650 (dy milion e katërqind mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë) **Lekë pa TVSH**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Tirana Parking ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës Nr3
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas shtojcës Nr.9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin, vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore për xhiron vjetore të 3 (tre) viteve të fundit ushtrimore (2020,2021,2022) ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se **20%** e vlerës së fondit limit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Lloji i procedurës është “Procedurë e Hapur e Thjeshtur”, përcaktimi i vlerës së kërkuar është bërë në mbështetje të nenin 43, pika 2c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43, pika 1, të VKM 285/2021 “Mbi Rregullat e Prokurimit Publik”, të ndryshuar, ku përcaktohet se: “*Autoriteti/enti kontraktor, për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, kërkon kopje të deklaratave të xhiros vjetore të realizuar nga operatori ekonomik, për një periudhë maksimumi deri në 3 (tre) vitet e fundit financiare*” si dhe në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Shërbime të një natyre të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për këtë duhet të paraqiten:

a) Kur shërbimet e ngjashme janë të realizuara me ente shtetërore, duhet të paraqitet kontrata e shoqëruar me vërtetimin e realizimit nga autoriteti kontraktor.

b) Kur shërbimet e ngjashme janë të realizuara në sektorin privat, duhet të paraqitet kontraten dhe faturat përkatëse tatimore të shitjes ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të shërbimeve të realizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5 (ose në rastin e procedurave të thjeshtuara në nenin 55, pika 4), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë me një vlerë jo më të vogël në 20 % të vlerës së fondit limit.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285 e 2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur me **Çertifikatën ISO 9001:2015** ose ekuivalent, lidhur me sistemin e menaxhimit të cilësisë, e cila të përfshijë objektin e prokurimit, si dhe të jetë e vlefshme. Të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit i vendit ose nga organizma ndërkombëtarë akreditues të njohur nga **Drejtoria e Përgjithshme e Akreditimit në Shqipëri (DPA)**.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, “*Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.*” dhe pika 1, neni 44, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. *Autoriteti, enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit.*

Për vete natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët të kryejnë shërbimin dhe realizojnë objektin

e kontratës me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësië është standart që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Kjo çertifikatë lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës përsa kohë do të pranohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërben autoritetit përgjegjes për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës.

Kriteri i mësipërm për paraqitjen e çertifikatës ISO është në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese për operatorët.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesi një vërtetim të lëshuar nga organet përkatëse (Drejtoria Rajonale Tatimore) për numrin e punonjësve të siguruar minimalisht për 6 (gjashtë) muajt e fundit, i cili duhet të ketë të punësuar mesatarisht jo më pak se **5 (pesë) punonjës** ku të jenë të përfshirë dhe stafi profesional, e shoqëruar dhe me listëpagesat (formulari E-SIG 025) për periudhën e sipër përmendur.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, si dhe nenit 41, pika 4/c, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” të ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën/kontratën që do të nënshkruhen në bazë të marrëveshjes kuadër.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të vërtetojë se ka të punësuar në stafin profesional, minimalisht **3 (tre) punonjës** të trajnuar për mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit të listuara në specifikimet teknike. Për plotësimin e kësaj kërkesë ofertuesit duhet të paraqesin çertifikatën e trajnimit, CV dhe kontratën e punës të vlefshme për të gjithë periudhën e kryerjes së shërbimit të kërkuar.

Shënim: Ky kriter do të përmbushet nga OE me anë të Formularit Përmbledhës së Vetëdeklarimit sipas Shtojcës 9. Operatori ekonomik i kualifikuar i pari në klasifikim duhet të dorëzojë pranë AK, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve ankimit, të gjithë dokumentacionin provues për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit. Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të kryejë të gjithë verifikimet e nevojshme për të vërtetuar deklarin e mësipërm.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të

kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi për mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit, objekt prokurimi, ku autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij. Autorizimi duhet të jetë origjinal i përkthyer dhe/ose fotokopje e noterizuara.

2.3.5 Ofertuesi duhet të paraqesë mirëmbajtjen preventive për secilën lloj pajisje sipas manualeve të përcaktuara nga prodhuesi, të përkthyer, të fotokopjuara dhe noterizuara ku të jetë përcaktuar procedura e kontrollit, pjesët që do të ndërrohen dhe shpeshtësia, intervalet kohore kur është përcaktuar të bëhet mirëmbajtja.

Argumentimi: Autorizimi i Prodhuarit është një dokument i rëndësishëm, pasi përveç se tregon origjinën e mallrave që kërkohen në procedurë, na garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin të AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në standartet apo prodhuar të zyrtarizuar. Ky kriter është jo diskriminues, është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues për aftësitë teknike. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-së për përmbushjen me sukses të kontratës. Ky kriter është në përputhje me Nenin 77, pika 4, të Ligjit Nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” dhe pikën 6, të nenit 40, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar)

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i posaçëm, i cili është ngritur me Urdhër të Titullarit për hartimin e specifikimeve të teknike në përputhje me nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar)

Autoriteti Kontraktor Tirana Parking ka ndër të tjera, një nga objektet kryesore dhe të rëndësishme të veprimtarisë së saj, mirëmbajtjen e sistemeve të parkimit. Specifikimet teknike shprehin tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe në përputhje të plotë me funksionet e kërkuara nga Autoriteti.

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo edhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tijësaj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.